

DIPLOMACIA SHQIPTARE MES DY LUFTËRAVE BOTËRORE
PERIUDHA 1919-1939

TEMA PËR TITULLIN

MASTER I SHKENCËS NË HISTORI TË KOHËS SË RE

NGA

FATLUM ADEMI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I HISTORISË
PRISHTINË

Maj, 2022

EKSPOZE E TEMËS

DIPLOMACIA SHQIPTARE MES DY LUFTËRAVE BOTËRORE PERIUDHA 1919-1939

Mentori:

Prof. Dr. Asoc. Nuri Bexheti

Kandidati:

Fatlum Ademi

Në këtë tezë diplome është trajtuar Historia e Shtetit Shqiptar që nga fillet e shtetndërtimit në vitin 1912 e deri tek sfidat që shtetit shqipëtarë kishte për ta mbajtur pavarësinë dhe shtetin e krijuar tashmë. Shqipëria njihet si shtet pas shumë vitesh e okupuar nga Perandoria Osmane. Shqiptarët aso kohe u munduan me çdo kusht ti mbronin të drejtat e tyre dhe t'i mbronin tokat e tyre nga pushtuesit. Ky punim përbën në vetëvete një histori e cila zë fill me Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë dhe vijon me zhvillimin e ngjarjeve të mëvonshme, si krijimi i qeverisë së parë shqipëtare të udhëhequr nga Fan Noli dhe pastaj qeverisë së dytë të udhëhequr nga Ahmet Zogu si dhe krijimit të mbretërisë nga mbreti Zogu I, me ç'rast Shqipëria shpallet mbretëri. Qëllimi i këtij punimi është, që t'u japë studiuesve dhe lexuesve një kuadër më të plotë të zhvillimeve diplomatike dhe politike në periudhën 1919-1939 mbi Shqipërinë midis dy luftërave botërore, rolin e veprimtarëve politik e atdhetar për mbrojtjen e tërësisë territoriale; përpjekjet për ngritjen e institucioneve të pavarura kombëtare e shtetërore. Kërcënimi për një ndarje të re të Shqipërisë, kishte bërë që politikanët dhe atdhetarët të mobilizoheshin për të marrë në dorë fatet e vendit. Shqipëria gjatë kësaj periudhe karakterizohet me ngjarje të mëdha historike si konferenca e Ambasadorëve, konferenca e Paqes, Lëvizja e Qershorit dhe ngjarje tjera historike që karakterizuan këtë periudhë. Në periudhën midis dy luftërave botërore, politika e Fuqive të Mëdha Evropiane dhe e vendeve ballkanike u karakterizua nga rivaliteti për hegjemoni në Ballkan dhe në Mesdhe, duke shfrytëzuar pozitën gjeostrategjike të Shqipërisë. Pjesë e skenarit diplomatik të shteteve evropiane ishte edhe Shqipëria. Me pozitën e favorshme gjeografike në Ballkan, që shërbente si vend kufitar midis Perëndimit e Lindjes dhe si portë hyrje në Adriatik, Shqipëria iu nënshtrua ndikimit dhe rivalitetit të fortë të Fuqive të Mëdha. Ato konkurrnin për zgjerimin e influencës politike e ekonomike në Ballkan, si dhe kontrollin mbi Detin Mesdhe. Kjo dinamikë gjeopolitike kushtëzoi qëndrimin e kancelarive evropiane ndaj Shqipërisë në zhvillimet e rëndësishme ndërkombëtare që përshkuan periudhën midis dhe pas dy luftërave botërore.

Qëllimi

Qëllimi i këtij i hulumtimi është të analizoj Diplomacinë shqipëtare në mes të dy luftërave botërore periudha 1919-1939, si nga ana e politikëbërës në atë kohë si nga aspekti i qëndrimeve të fuqive të mëdha të asaj kohe karshi Shqipërisë dhe aleatëve të saj. Shqipëria e aso kohe njihet për dy qeveritë e saj që krijoi qeverine e Ahmet Zogut dhe qeverinë e Fan Nolit. Përpjekjet e shqipëtarëve nuk rreshtën për shtetndërtim dhe ruajtjen e terësisë territoriale të Shqipërisë edhe pse hasen në pengesa të mëdha nga shtete fqinje si Austrohungaria, Italia dhe Serbia. Qëllimi i hulumtimit për të realizuar këtë punim është që të trajtojmë në frymën e shkencës së historisë ‘‘Diplomacia shqipëtare në mes të dy luftërave botërore periudha 1919-1939’’. Që kjo punë të jetë sa më e tërësishme, jemi nisur nga fillimi i luftës së parë botërore, historiku i shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë e deri tek lufta e dytë botërore. Sa i përket temës që unë e trajtova kam marrë për studim dhe kam bërë analiza në bazë të hulumtimeve dhe literaturës që kam poseduar dhe jam munduar të sjellë në pahë gjëra të vërteta dhe të qëndrueshme, jam munduar që gjatë këtij punimi të shfrytëzoj sa më shumë burime të dorës së parë.

Metodat dhe objektivat e studimit

Në trajtesën e kësaj teme metodat e hulumtimit shkencorë, të cilat janë përdorur që kjo temë të jetë sa më produktive dhe sa më afër së vërtetës janë ato: induktive dhe deduktive, të analizës dhe sintezës, si dhe të deskripsionit.

Ky punim është trajtuar duke u mbështetur në literatura që kishin të bënin me të direkt ose indirekt, nga gazetatat e kohës, nga Arkivet shtetërore nga literatura si librat dhe publikimet shkencore në internet.

Organizimi i punimit

Ky punim masteri është strukturuar në katër kapituj kryesorë të ndarë në disa nënkapituj. Secili prej tyre trajton çështje të veçanta me synim përmbushjen e objektivave. Me gjithë përpjekjet dhe punën e mundimshme për të pëfshirë të dhënat kryesore të temës së paraparë me projektin ideor jam i vetëdijshëm se ka akoma për t’u bërë në këtë fushë, që ndoshta ndonjëherë në të ardhmen në ndonjë punim tjetër do t’u rikthehem dhe do t’i plotësoj më shumë. Shpresoj se ia kam arritur sado pak qëllimit të jap një këndvështrim modest për ‘‘Diplomacinë shqipëtare në mes të dy luftërave botërore’’.

Kapitulli I Periudha gjatë viteve 1920-1924 ishte periudhë kryesisht paqëndrueshmërie për

Shqipërinë. Në vitin 1920 u krijua partia e parë në Shqipëri Partia Popullore, e para parti shqiptare në histori. Kjo parti përfaqësonte rrymën antikonservatore, liberale dhe përparimtare. Pjesë e kësaj partie ishin disa figura eminente të kohës si: Fan Noli, Ahmet Zogu, Luigj Gurakuqi, Bajram Curri etj. Në qershor të vitin 1924, Fan Noli me mbështeteshit e tij udhëhoqi Revolucionin Demokratik të qershorit. Nga fundi i vitit 1920-të Ahmet Zogu udhëhoqi kundërrevolucionin dhe me anë të kësaj u rikthye në pushtet. Në vitin 1920 Ahmet Zogu u shpall nga parlamenti i shtetit Shqipëtar Zogu I, Mbret i Shqiptareve, Skënderbeu III. Mbretëria Zogu u shpall mbretëri kushtetuese, parlamentare dhe e trashëgueshme. Në këtë mënyre për herë të parë u krijua e para familje mbretërore shqiptare. Parlamenti i dha mbretit Zog shumë çifligje dhe para.

Kapitulli II trajton Historinë e Shqipërisë dhe sfondi diplomatik gjatë viteve 1920-1939 dhe ngajret politike që ndodhën gjatë kësaj periudhe. Kongresi i Lushnjës, që njihet si një ngjarje e madhe e historisë së kombit tonë u mbajt prej 21-deri më 31 janar të vitit 1920, në të cilin u miratua një akt kushtetues për pavarësinë e plotë të Shqipërisë. Gjatë ditëve të punimeve Kongresi zgjodhi këshillin e lartë prej 4 vetash, që do të kryente funksionet e kryetarit të shtetit dhe një këshill kombëtar me 37 veta. Kryeministër u zgjodh Sulejman Delvina. Qëllimi i Kongresit ishte studimi i situatës së brendshme dhe të jashtme të vendit dhe masat që duhet të merreshin për shpëtimin nga rreziku i copëtimit të Shqipërisë. Ky kongres mbajti gjithsej katër mbledhje ku ne disa prej tyre rezultuan disa vendime të mëdha si krijimi i qeverisë së Durrësit dhe rrëzimi i saj e po ashtu edhe krijimin e qeverisë së re me Sulejman Delvinen kryeministër.

Kapitulli III trajton formimin e partive të para politike dhe dy qeveritë e para shqiptare njëra e krijuar nga Fan Noli dhe tjetra nga Ahmet Zogu, kapitulli i tretë po ashtu trajton edhe krijimin e Shqipërisë apo shtetit shqiptar mbretëri. Okupimi i shtetit shqiptar nga Italia fashiste shqetësoi diplomacinë evropiane. Ai ishte në kundërshtim me kushtet e marrëveshjes anglo-italiane për ruajtjen e status quo-së në Mesdhe. Pushtimi italian i Shqipërisë nuk solli reagimin e Lidhjes së Kombeve, çka tregonte paefekshmërinë e saj për të vepruar në përputhje me statutin e organizatës. Me porosi të mbretit Zog, i ngarkuari me punë në Paris, Mehmed Abid, i dërgoi një notë që denonconte agresionin Sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes, Joseph Avenol. Ai e konsideroi veprimin jointitucional sepse kërkesa nuk i takonte as qeverisë shqiptare dhe as përfaqësuesit të saj të akredituar në Gjenevë. Rrethana që e detyruan Zogun t'i bënte vetë thirrje Sekretarit të Përgjithshëm ta ndihmonte Shqipërinë për rivendosjen e pavarësisë. Tentativë që u kufizua me leximin e letrës. Nën drejtimin italian, Shqipëria u largua nga Lidhja e Kombeve, më 14 prill 1939.

Kapitulli IV trajton rolin e Fuqive të mëdha evropiane dhe shqipërisë gjatë luftës së dytë botërore, se si u sollën ato me Shqipërinë politikisht dhe cili ishte roli i tyre në vendimet

shtetndertuese në Shqipëri, prej ruajtjes së kufinjve deri tek tregëtia e lire. Politika e Fuqitë të Mëdha fituese të luftës, në Konferencën e Paqes së Parisit, nuk lejoi konsolidimin e pozitës së Shqipërisë në arenën ndërkombëtare. Paqebërësit e përdorën çështjen shqiptare si mjet këmbimi për të kënaqur interesat e shteteve fqinjë. I tillë ishte kompromisi anglo-franko-italian i 13-14 janarit 1920, që parashikonte copëtimin e Shqipërisë ndërmjet Greqisë, Jugosllavisë dhe Italisë. Misioni diplomatik pranë kancelarive evropiane i ndërgjegjësoi delegatët shqiptarë për mendimin dominues mbi Shqipërinë. Ata kishin konstatuar se Fuqitë e Mëdha i konsideronin shqiptarët të përçarë dhe të paaftë për të përkrahur zgjidhjen e problemit kombëtar. Qëndrim që nxiti delegatët L. Bumçi dhe Dr. Turtulli të sygjeronin disa orientime në politikën e jashtme që duhej të ndiqte qeveria shqiptare.